



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E AELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:265428

Datë: 30.12.2025

Numri i dokumentit: 08279011

PAKR.nr.318/2025

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E AELIT E KOSOVËS, Departamenti i Krimeve të Rënda – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryetar i kolegjit, Kadrije Goga-Lubishtani dhe Metor Hajraj - anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Syzana Goxhuli, në çështjen penale kundër të akuzuarit Tom Dodaj për shkak të veprës penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse nga neni 364, par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur më ankesën e mbrojtësit të akuzuarit Tom Dodaj, av.Agron Kuqi, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.21/25, datë 26.02.2025, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të KPPK-se, me datë 10.12.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e të akuzuarit Tom Dodaj e paraqitur përmes avokatit mbrojtës Agron Kuqi, ashtu që NDRYSHOHET: Aktgjykimi i Gjykatës Themelore - Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë PKR.nr.21/25, i datës 26.02.2025, përkitazi me sanksionin penal – dënimin, dhe të akuzuarit për veprën penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse nga neni 364, par.1 të KPRK-së, i shqiptohet dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite, si dhe dënim me gjobë prej tremijë (3000)€ të cilat dënime do të ekzekutohen pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në pjesët e tjera aktgjykimi mbetet i paprekur.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.21/25, datë 26.02.2025të akuzuarin Tom Dodaj për shkak të veprës penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse nga neni 364, par.1 të KPRK-së, e ka shpallur fajtor dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 5 (vite) dhe dënim me gjobë në shumën prej 5,000.00 (pesë mijë) € (euro), të cilat dënime do të ekzekutohen 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, pasi që ky aktgjykim të bëhet i plotfuqishëm.

Nëse dënimi me gjobë nuk paguhet në mënyrë vullnetare nga i akuzuari, dënimi me gjobë do ti shndërrohet në dënim me burg, Gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga një 1 (një) ditë burgimi për 20 (njëzet € (euro) të gjobës.

Konform nenit 79 par.1 të KPRK-së, në dënimin e shqiptuar të akuzuarit Tom Dodaj, do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 09.12.2023 deri me datë 17.04.2024.

Është obliguar i akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurale dhe atë për paushallin gjyqësor shumën prej 50 (pesëdhjetë) € (euro) dhe në emër të kompensimit për fondin e viktimave të krimit, shumën prej 50 (pesëdhjetë) € (euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit familja A., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, nuk udhëzohen në kontest të rregullt juridiko civil, pasi që kanë hequr dorë nga kjo kërkesë, në raport me këtë të akuzuar.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar

Mbrojtësi i të akuzuarit Tom Dodaj, av.Agron Kuqi, për shkak të vendimit mbi lartësisë e dënimit dhe shkeljes së parimit të ligjshmërisë, më propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoi ankesën, ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta anuloj dhe çështjen ta kthen në rigjykim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë ose të njëjtin ta ndryshoj dhe të akuzuarit ti shqiptoj dënim me të butë, përkatësisht dënim me gjobë dhe dënim me kusht me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit.

Prokurori i Apelit më parashtresën, PPA/I.nr.293/2025, datë 04.06.2025, ka propozuar që të refuzohet ankesa e mbrojtësit të Tom Dodaj, av.Agron Kuqi si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e caktoj dhe e mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPRK-së, në të cilën morën pjesë i dëmtuari L.A. dhe përfaqësuesi i tij av.Leutrim Sylja, i akuzuari Tom Dodaj si dhe mbrojtësi i tij av.Agron Kuqi, kurse nuk ka prezantuar Prokurori i Apelit edhe pse është njoftuar në mënyrë të rregullt nuk mori pjesë në seancë. Gjatë seancës përfaqësuesi i të dëmtuarit L.A., av.Leutrin Sylja, ka propozuar që dënimi të vërtetohet edhe pse është tërhequr nga kërkesa pasurore juridike për të mos ia rënduar pozitën të pandehurit edhe pse familja Ademaj i ka hapur dyert për z.Dodaj por ai nuk është paraqitur për ngushëllime, kurse mbrojtësi i të akuzuarit Tom Dodaj, av Agron Kuqi, mbeti pranë pretendimeve të parashtruara në ankesë që të akuzuari ti shqiptohet një dënim i kushtëzuar me gjobë me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit, ndërsa i akuzuari pasi shprehu ngushëllime familjes e mbështeti mbrojtësin e tij.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, studioj aktgjykimin e kundërshtuar konform dispozitës së nenit 394 të KPPRK-së dhe pasi që vlerësoi pretendimet ankimore në ankesa gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtën e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare edhe në këtë aspekt konform nenit 394 par.1 të KPPK-së, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të tjera të cilat detyrimisht do të kushtëzonin prishjen e tij.

Po ashtu, me ankesë nuk kontestohet as gjendja faktike të cilën e ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë, prandaj as në këtë drejtim çështja nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate (pasi që nuk mund të kontestohet aktgjykimi përkitazi me këtë bazë ankimore ngase të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë, kurse aktgjykimi u vlerësua vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore sa i përket vendimit mbi dënim.

Pretendimet e mbrojtësit në ankesë

Në ankesë mbrojtësi i të akuzuarit Tom Dodaj, av.Agron Kuqi ka theksua se me aktgjykimin e ankimuar nuk janë vlerësuar rrethanat lehtësuese me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit, për faktin se vepra penale është kryer pa qellim kriminal, dashje ose keqdashje ndaj shoqërisë apo individëve, por si rrjedhojë e pakujdesisë dhe padijenisë se te pandehurit dhe mungesës se ndërgjegjësimit për pasojat që mund të sillte, ashtu që në momentin e kryerjes së veprës penale, veprimi ka qenë i izoluar dhe i rastësishëm pa pasur dijeni mbi qëllimet e te pandehurve të cilëve ju është shitë arma dhe pa i njohur dhe pa pasur asnjë lloj lidhjeje me ta. Sipas mbrojtës i pandehuri ka pranuar fajësinë në të gjitha fazat e procedurës penale dhe është penduar sinqerisht, për më tepër i njëjti është kryefamiljar dhe mbajtës i familjes gjashtë anëtareshë, punon në punëtorinë e tij familjare të autolarjes, deri me tani asnjëherë nuk ka renë ndesh me ligjin, i njëjti është lajmëruar në ftesën e pare të institucionet kompetente, ka pranuar shitjen e paautorizuar të armës të pandehurve si dhe ka ofruar gatishmëri për të bashkëpunuar dhe për të ndihmuar për çdo informatë. Andaj, pavarësisht rrethanave të lartcekura renduese, ka aq shumë rrethana lehtësuese, ku gjykata ka mundur të merr një dënim dukshëm më të butë, se paku ka pasur mundësi ligjore që të shkon afër minimumit e jo si në rastin konkret dënimi është afër maksimumit. Ka shtuar se ky dënim është në kundërshtim edhe me dispozitat e parimit të ligjshmërisë, ku ka të bëjë me politikën ndëshkimore unike në raport me gjykatat e tjera që të shqiptojnë dënime të njëjta apo ngjashme dhe tutje i referohet dispozitave ligjor në raport me ndëshkueshmërinë e veprës penale, me pretendim se dënimi i shqiptuar është jashtë standardeve ligjor andaj për arsye të lartcekura ka propozuar si më lartë.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit lidhur me vendimin mbi dënim

Përkitazi me vendimin mbi dënimin Gjykata e Apelit, konstaton se pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit për një dënim më të butë janë të bazuara.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësisë së dënimit në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ku si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin ka vlerësuar pranimin e fajësisë në të gjitha fazat e procedurës, pendesën dhe kërkim faljen familjes së dëmtuar, për veprën penale të kryer edhe pse vet nuk kishte qenë në dijeni se për çfarë do të përdorej arma që kishte shitur, ndërsa si rrethanë renduese ka vlerësuar dhe ka marrë për bazë rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale. Duke i vlerësuar rrethanat e lartcekura të akuzuari i ka shqiptuar dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se me këtë dënim do të arrihet qëllimi dënimit.

Dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë prej 5 (pesë) vite burgim dhe dënim më gjobë prej 5 (pesëmijë) euro në rrethanat e çështjes rezulton se është dënim i ashpër, duke pasur parasysh rrethanat lehtësuese të pranimit të fajësisë në të gjitha stadet e procedurës penale, të cilës rrethanë nuk i është dhënë rëndësia e duhur me rastin e caktimit të dënimit, në ndërlidhje edhe me rrethanat e tjera si pendimin e tij, gatishmërinë për bashkëpunim, kërkim faljen familjes së dëmtuar për veprën penale të kryer, faktin se nuk kishte qenë në dijeni se për çfarë do të përdorej arma që kishte shitur, përveç këtyre qëndron edhe fakti se nga shkresat e lëndës rezulton se për të pandehurin kjo ishte hera e parë që bie ndesh me ligjin si dhe rrethanat familjare është i martuar babi i tre fëmijëve, mbajtës i familjes, rrethanat e tilla në unitetin tyre tregojnë se edhe me një dënim më të ulët, të caktuar tani si në dispozitiv mund të arrihet qëllimi ndëshkimor i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ndaj të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe më intensitetin e rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe se më të do të mund të parandalohet i akuzuari nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Nga arsyet e sipër cekura e në bazë të nenit 403 par.1 nënpar 1.2 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr.315/25, datë 10.12.2025